

Nr. Prot. 013/B/20**VENDIMI Nr. 1529****Për****'Fillimin e Procesit të Analizës së Tregut të
Terminimit të Thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale'**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 10 paragrafi 5) neni 31, paragrafët 1) dhe 3) nën-paragrafi 3.3 dhe neni 79 paragrafi 2) (*tutje referuar si; Ligji*); Rregullores Nr. 42 për Analizat e Tregut, (*Ref. ARKEP Nr. Prot. 110/B/19*), neni 3, paragrafët 3.1), 3.3) dhe 3.4), neni 4, paragrafi 4.3.2) (*tutje referuar si; Rregullorja për Analizat e Tregut*), dhe neni 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Bahri Anadolli Anëtar
- 2) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 3) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 4) z. Shqiprim Pula Anëtar

në mbledhjen e 53-të me radhë të mbajtur me datë 28 Shkurt 2020, bazuar në shqyrtimin e administruar të materialeve të lëndës, si dhe rekomandimit të paraqitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (*DKE*), me qëllim të jetësimit të dispozitave të legjislacionit të aplikueshëm, vendosi si më poshtë;

VENDIM

- I. Miratohet fillimi i procesit të analizës së tregut; **'Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale'**.
- II. Procesi i analizës së tregut të specifikuar në pikën I) të këtij vendimi fillon më datë; **16 Mars 2020** dhe përfundon më datë **15 Korrik 2020**.
- III. Obligohet Departamenti i Komunikimeve Elektronike që të zbatoj pikat I) dhe II) dhe t'ia paraqes Bordit të Autoritetit Draft Raportin së bashku me draft vendimet përkatëse nga procesi i Analizës së Tregut.
- IV. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 31 (*Analiza e tregut*), paragrafi 1) përcakton se procedura e analizës së tregut duhet të iniciohet me një vendim paraparak të Autoritetit. Po ashtu i njëjti nen, paragrafi 3.3) përcakton se Autoriteti ka të drejtë që të bëjë një analizë të tregut me vetiniciativën e tij.

Neni 3 paragrafi 3.3 përcakton se; *Autoriteti ka të drejtë që të bëjë një Analizë të Tregut me vet-iniciativën e tij.*

Neni 31, paragrafi 8) i Ligjit përcakton se; *'Autoriteti duhet ta kompletoj procedurën e analizës së tregut brenda 4 muajve pas vendimit të Autoritetit'.*

Rregullorja për Analizat e Tregut përcakton procedurat dhe principet bazë të procesit të përkufizimeve dhe analizës së tregut, përcaktimin e ndërmarrjeve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe imponimin e detyrimeve rregullatore *'ex-ante'*, për të zgjidhur problemet e identifikuar të konkurrencës.

Neni 4 (*Përcaktimi i Tregjeve Përkatëse*) i Rregullores për Analizat e Tregut, paragrafi 4.3) ka përcaktuar si treg të veçantë; *'Tregun e terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale'.*

Neni 3.13 i Rregullores për Analizat e tregut specifikon se *"Autoriteti duhet ta bëjë/rishikojë secilin treg nëse pritet që konkurrenca në atë treg ka ndryshuar, jo më pak se një herë në çdo tri (3) vjet nga vendimi i kaluar përfundimtar i Autoritetit për rezultatet e analizës së tregut. Periudha e analizave pasuese të një tregu përkatës mund të vazhdohet deri në tri (3) vite shtesë me vendim të arsyetuar të Autoritetit"*.

Së këndejmi, Autoriteti në përmbushje të objektivave rregullatore të përcaktuara me Ligj dhe detyrave të parapara sipas Programit Vjetor të Punës për vitin 2020, ku është përcaktuar iniciimi dhe kryerja e analizës së tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.

Andaj, me qëllim të;

- Zbatimit të Ligjit, promovimit të investimeve dhe konkurrencës së lirë në tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës;
- Krijimit të kushteve dhe sigurimit të konkurrencës efektive në fushën e komunikimeve elektronike dhe parandalimit të shpërdorimit të fuqisë në treg nga ndërmarrësit me FNT;
- Krijimit të sigurisë ligjore përmes përcaktimit të kornizës ligjore, rritjes së transparencës;

Atëherë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike;

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 04/ 03/ 2020

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Aktvendimi i dërgohet;

- Ndërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP;
- Departamentit Ligjor, ARKEP; dhe
- Arkivit, ARKEP